



**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova / Republic of Kosovo*  
**Agjencia kundër Korrupsionit**  
*Agjencia protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency*



**10** Vite

Me Agjencinë kundër  
Korrupsionit

Një **JO** e juaja ka  
**PESHË**

Ky publikim i dedikohet 10 vjetorit të themelimit të Agjencisë kundër Korrupsionit, ku pasqyrohen të dhënat e detajuara në lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e këtij insitucioni...

---

## AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT


Agjencia kundër Korrupsionit në vijim (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të viti 2007. Baza ligjore për themelimin e Agjencisë është Ligji kundër Korrupsionit (2004/34) i cili i kishte përcaktuar përgjegjësitë dhe fushë-veprimtarinë e saj. Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Kompetencat e Agjencisë janë të përcaktuara në nenin 5 të Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Bazuar në kuadrin ligjor AKK për punën e vetë duhet ti raportoj në baza vjetore Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm i AKK-së është i rregulluar me anë të Rregullores së Punës së AKK-së dhe Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKK. Ato përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat në lidhje me kryerjen e punëve si dhe përgjegjësitë e çdo zyrtari brenda AKK-së. AKK përbëhet nga Zyra e Drejtorit, Departamentet, Divizionet dhe Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim. Aktualisht përbëhet nga një staf prej 40 zyrtarësh, ndërsa selia e saj është e vendosur në Rr. “Nazim Gafurri”, nr. 31, në Prishtinë



## DEPARTAMENTI PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Departamenti për Luftimin e korrupsionit (në vijim të tekstit DLK) është një nga njësitë organizative të Agjencisë kundër Korrupsionit (në vijim të tekstit Agjencia). DLK udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit. Në këtë departament janë të punësuar 11 zyrtarë.

DLK është themeluar me vendim të Drejtorit të Agjencisë duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat ligjore për kryerjen në mënyrë efikase dhe efektive të detyrave dhe përgjegjësive të Agjencisë të përcaktuara sipas legjislationit në fuqi. DLK detyrë parësore e ka inicimin dhe zhvillimin e procedurës së zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjelljen e kallëzimeve penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale apo përcjelljen e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore tek organi administrativ kompetent në rast se nuk dyshohet për vepër penale por për shkelje administrative, analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike, bashkëpunimin me prokuroritë publike kompetente dhe me të gjitha institucionet tjera për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, përgatitjen e propozimeve dhe plotësimeve për ndryshimet e legjislationit që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit, si dhe detyra tjera.

Aktualisht në kuadër të departamentit ekzistojnë dy divizione: Divizioni për Hetime dhe Analiza dhe Divizioni për Hetime dhe Strategji. Divizioni për Hetime dhe Analiza detyrë parësore e ka zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake për rastet e dyshuara për korrupsion si dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Ndërsa, Divizioni për Hetime dhe Strategji detyrë parësore e ka zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake për rastet e dyshuara për korrupsion si dhe hartimin, monitorimin e zbatimit, raportimin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike të nxjerra nga institucionet tjera. Dy Divizionet kanë numër të barabartë të zyrtarëve, nga 5 zyrtarë secili.

Në të kaluarën DLK është titulluar si Departamenti i Hetimeve ku përgjegjësitë dhe detyrat kanë qenë të përcaktuara sipas Ligjit nr. 2004/34 kundër Korrupsionit. Edhe dy Divizionet përbërëse me vendime për organizim dhe sistematizim të brendshëm të Agjencisë kanë pësuar ndryshime në emërtimin e tyre. Përderisa sipas këtij ligji procedura e hetimeve të cilën e ka ndërmarrë ky departament është titulluar si procedurë e hetimeve administrative, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-159, titullohet si procedurë e hetimeve paraprake.

Trendi i numrit të rasteve të trajtuara nga DLK ndër vite është rritur, po ashtu edhe numri i rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare (ex- officio). Numri i rasteve të përcjella në prokurori publike kompetente apo të përcjella si kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore tek organi administrativ kompetent në rast se nuk dyshohet për vepër penale por për shkelje administrative dhe numri i personave të përfshirë në to ka ndryshuar nga viti në vit. Si rezultat i rasteve të përcjella, prokuroritë kanë iniciuar procedura penale duke zhvilluar hetime ose duke ngritur propozim akuza dhe aktakuza. Janë zhvilluar edhe procese gjyqësore, ku disa edhe vijnë. Po ashtu, organet administrative kompetente të cilave Agjencia iu ka përcjellë kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore kanë filluar dhe kanë shqiptuar masa të caktuara kundër personave të përfshirë. Pengesat e paraqitura lidhur me informacionet kthyesë sa i përket rasteve të përcjella janë tejkualuar. DLK në vazhdimësi ka studiuar dhe përcjellë trendët pozitive të zhvillimit të kornizës ligjore anti- korrupsion në vendet e rajonit dhe ato evropiane, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të kornizës ligjore anti- korrupsion në Kosovë, ashtu që në mënyrë aktive është angazhuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër Korrupsionit dhe legjislacionit tjetër anti- korrupsion. Në kuadër të Agjencisë, nën udhëheqjen e Drejtorit të Agjencisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare dhe joqeveritare DLK ka qenë e përfshirë në hartimin e Strategjive dhe Planeve të Veprimit kundër Korrupsionit për periudhat strategjike 2009-2011 dhe 2013-2017, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. DLK ka përgatitur raporte të veçanta mbi monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, si dhe raporte mbi analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë. DLK me qëllim të implementimit të detyrave dhe përgjegjësië ligjore dhe funksionalizimit më të madh të Agjencisë, ka kontribuar edhe në zhvillimin e akteve të brendshme nënligjore.

Tabela e mëposhtme tregon në saktësi rastet e pranuar, numrin e rasteve dhe personave të përcjella në prokurori, si dhe numri i rasteve dhe personave të përcjella me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore nga viti 2007 – 2016.

## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Viti	Nr. I rasteve të pranuara	Nr. I rasteve dhe personave të përcjella në Prokurori		Nr. I rasteve dhe personave të përcjella me kërkesë për fillimin e procedurave disiplinore	
		Rastet	Personat	Rastet	Personat
<b>2007</b>	124	47	91		
<b>2008</b>	130	53	113		
<b>2009</b>	175	68	159		
<b>2010</b>	139	33	164	2	5
<b>2011</b>	160	39	121	5	7
<b>2012</b>	164	52	159	7	7
<b>2013</b>	247	128	238	8	8
<b>2014</b>	248	131	163	11	23
<b>2015</b>	298	126	189	14	26
<b>2016</b>	117	29	37	16	26
<b>Totali</b>	1802	706	1434	63	102

## DEPARTAMENTI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Duke u bazuar në mandatin e AKK gjithë aktiviteti për parandalimin e korrupsionit zhvillohet përmes Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit. E gjithë kjo bëhet duke u bazuar në kompetencat ligjore që i ka Agjencia sipas ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, ligjit nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë si dhe ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Departamenti i parandalimit aktivitetin e vet e ushtron përmes tre divizioneve:

- a) divizioni për mbikëqyrjen e pasurisë dhe dhuratave;
- b) divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit;
- c) divizioni për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.





## DEKLARIMI DHE MBIKËQYRJA E PASURISË, 2007-2016

Deklarimi i pasurisë fillimisht ka qenë i rregulluar apo përcaktuar me ligjin nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit, ky ligj ka paraparë disa pozita të larta publike që duhet të paraqesin deklarin e pasurisë për disa zyrtarë të lartë publikë, numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë në vitin 2007 ka qenë 732 zyrtar të lartë publik. Ky ligj ka paraparë 4 lloje të deklaramit të pasurisë: Deklarimin me marrjen e detyrës; deklarin e rregullt vjetor; deklarin sipas kërkesës; si dhe deklarin pas largimit. Ky ligj ka paraparë edhe mundësin e afatit shtesë sa i përket deklaramit të pasurisë dhe këtë afat ka pasur të drejt të përcaktoj Agjencia. Sanksionet e parapara me këtë ligj kanë qenë: kërkesë për ndaljen e pagës 1/5 deri të paraqet deklarin, mirëpo nëse vazhdon ma gjatë se tre muaj dhe nuk paraqet deklarin atëherë Agjencia ka kërkuar nga institucioni kompetent fillimin e procedurave për shkarkim.



Numri i zyrtarëve të lartë publik për çdo vite është rritur, në vitin 2008 kanë qenë 747 zyrtar të lartë publik, në vitin 2009 kanë qenë 800 zyrtar të lartë publik. Ku ligj ka përcaktuar se deklarimi i pasurisë nuk është publik. Në vitin 2010 Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë për herë të parë ligjin e veçantë që ka rregulluar çështjen e deklarimit të pasurisë dhe është emëruar Ligji me nr. 03/L -151 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë. Ku ligj ka pasur një avancim sa i përket rrethit të zyrtarëve të lartë publik sanksioneve dhe publikimin të pasurisë.

Numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë është dyfishuar dhe është bërë 1560 zyrtarë të lartë publik. Ky ligj ka rregulluar edhe çështjen e publikimit të pasurisë së deklaruar në ueb faqen zyrtare të Agjencisë, po ashtu ku ligj ka paraparë edhe sanksione tjera për deklarimin e pasurisë, Mos deklarimi i pasurisë është kategorizuar si kundërvajtje dhe sanksionet për mos deklarim të pasurisë kanë qenë nga 300 Euro deri në 1500 euro.

Në vitin 2011 përsëri është nxjerr ligji nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, ky ligj kaq rritur numrin e zyrtarëve të lartë publik dhe po ashtu ka ndryshuar shumën e dënimeve për mos deklarim të pasurisë. Dënime për mos deklarim të pasurisë kanë qenë nga 1000 euro deri në 2500 euro.

Me hyrjen e kodit penal në fuqi në vitin 2013 për herë të parë është sanksionuar si vepër penale mos deklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rremë i pasurisë.

Po ashtu është bërë plotësim ndryshimi i ligjit për deklarim të pasurisë dhe është harmonizuar me kodin penal, dhe gjithashtu është rregulluar edhe mënyra e përzgjedhjes së zyrtarëve që do ti nënshtrohen kontrollit të plotë.

Tabela e mëposhtme tregon me saktësi procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik nga viti 2007-2016

## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Deklarimi dhe Mbikqyrja e pasurisë 2007 – 2016				
Vitet	Të obliguar	Të deklaruar	Nuk deklaruan	Përqindja e realizuar
2007	732	718	14	98.08%
2008	790	776	14	98.22%
2009	830	814	16	98.07%
2010	1826	1749	77	95.78%
2011	2251	2165	86	95.17%
2012	4043	3737	306	92.43%
2013	4220	4185	35	99.17%
2014	5196	5103	93	98.21%
2015	4811	4754	57	98.81%
2016	4352	4319	33	99.24%
<b>Totali</b>	<b>29,051</b>	<b>28,320</b>	<b>731</b>	<b>97.48%</b>

## KONFLIKTI I INTERESIT

Konfliktit i interesit është nocion i ri në teorinë dhe praktiken juridike në Kosovë, daton që nga paslufta në Kosovë. Për herë të parë në vitin 2005 si akt normative është nxjerrë Ligji nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit me të cilin në mënyrë parimore është rregulluar çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në kuadër të këtij ligji është rregulluar çështja e papajtueshmërisë në mes të mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar si dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtar ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë. Poashtu ky ligj ka përcaktuar mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe ka paraparë masat e parapara me ligj të veçantë.

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna për Agjencinë kundër Korrupsionit nga Ligji kundër Korrupsionit që kanë pasur të bëjnë me konfliktin e interesit, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë veprime të caktuara në pajtim me dispozitat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit. AKK- në vazhdimësi i ka shqyrtuar formularët e paraqitur të deklarimit të pasurisë për të verifikuar ekzistencën apo jo të konfliktit të caktuar të interesit tek zyrtarët e lartë publik.

Pas funksionalizimit të AKK-së, është bërë kërkesë për një ligj të veçantë, në vitin 2007 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin nr. 02/I-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Objekt i këtij ligji ka qenë çështja e rregullave, subjekteve, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, t'Orajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Ky ligj ka përcaktuar rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar, kur ai merr pjesë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, në një vendimarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT



Ne kuadër të këtij ligji është përcaktuar subjekti zbatues i dispozitave që rrjedhin nga ligji NR. 02/L-133, është përcaktuar nocioni i konfliktit të interesit, janë përcaktuar Parimet e veprimit për zyrtaret e lartë, Kufizimi i zyrtarit në ushtrimin e veprimtarive të tjera jashtë ushtrimit të funksionit, Veprimet e ndaluara për zyrtarin, Kufizimet e zyrtarit pas largimit nga ushtrimi i funksionit publik, Anëtarësia e zyrtarit në organizata joqeveritare, Detyrimi i zyrtarit për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe një procedura e rëndësishme që nuk ka qenë me herët e përfshirë në Ligjin kundër Korrupsionit, Bartja e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes, e cila procedurë ka përshkruar mënyrën e bartjes së drejtimit të ndërmarrjes private gjatë kohës së ushtrimit të funksionit, si dhe Kufizimet e zyrtarit pas largimit nga ushtrimi i funksionit publik.

AKK-ë gjatë kësaj periudhe ka mbështet punën e vet për parandalimin e konfliktit të interesit në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik LIGJI NR. 02/L-133, situatat më të shpeshta të paraqitjes së konfliktit të interesit që janë shfaqur në atë periudhe kanë qenë kur : personat e lartë zyrtar përveç se kanë ushtruar një pozitë zyrtare, ata në anën tjetër kanë ushtruar edhe funksione menaxhuese nëpër ndërmarrje të ndryshme private, janë ofruar Opinione për situata të ndryshme të konfliktit të interesit. Krahas kësaj puna e AKK-së është shtrirë në sensibilizimin e opinionit (zyrtarëve të lartë) për rolin dhe rëndësinë e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik duke shfrytëzuar takimet të ndryshme, debatet, prezantime, etj. Në Dhjetor 2009 nga Kuvendi I Republikës Kosovës është nxjerr Ligji nr. 03/I-155 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 02/I-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ky ligj edhe pse nuk ka qenë voluminoz ka rregulluar disa paqartësi që kanë ekzistuar në ligjin NR. 02/L-133 .

Duhet veçuar se në vitin 2011 pasi janë vërejtur disa mangësi nga ligjet e më hershme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe duke pasur parasysh avancimin sipas standardëve në këtë fushë, Kuvendi I Republikës së Kosovës ka nxjerrë Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Ky ligj përbën njërin nga ligjet kryesore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. LPKI përbën aktin kryesor juridik nga fusha e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Dispozitat e ligjit nr.04/L-051 përcaktojnë rregulla të detyrueshme për zyrtaret e lartë publik që gjatë ushtrimit të funksionit të parandalojnë konfliktin e interesit të tyre në mes të interesave publike dhe private, si dhe përcakton kufizimet bazë për zyrtaret e lartë publik për ushtrimin e funksionit publik dhe funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike. Nga dispozitat kryesore të ligji nr.04/L-051 të cilat I japin formë parandalimit të konfliktit të interesit duhet përmendur Deklarimin e rregullt të Interesave, Deklarimi rast pas rasti I interesave private, Papajtueshmëritë gjate ushtrimit të funksionit publik, kufizimit gjatë ushtrimit të funksionit publik, kufizimit pas përfundimit të funksionit publik, Deklarimi rast pas rasti i interesave private, Transferimi i të drejtave në drejtim të ndërmarrjes, Anëtarësia e zyrtarit në organizata jo-Qeveritare etj.

Agjencinë kundër Korrupsionit vazhdon aktivitetin e saj duke zbatuar përgjegjësit e saj që rrjedhin nga ky Ligj nr.04/L-051 duke trajtuar rastet e konflikt të interesit, dukë ofruar Opinione, Këshilla, trajnime për çështjet e Konfliktit të interesit për zyrtar të lartë si dhe për institucione.

Agjencia kundër Korrupsionit përmes Departamentit të Parandalimit, përkatësisht Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë kësaj periudhe angazhimin e vet e ka fokusuar në dy drejtime : i pari, në atë të parandalimit të konfliktit të interesit dhe i dyti, në luftimin e konfliktit të interesit si pjesë e angazhimeve të AKK në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit.

AKK-ja përmes Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka zhvilluar aktivitetin e vet që për qëllim ka pasur identifikimin, shqyrtimin, analizën, paralajmërimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit.

Po ashtu Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka qenë i përfshirë në disa nisma ligjore, ka ofruar trajnime sa i përket fushës së konfliktit të Interesit për institucione të caktuara.

Burimet e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit:

Për AKK-në ekziston një numër i ndryshëm burimesh identifikuese të rasteve nga të cilat veç e veç rezulton dyshimi i arsyeshëm se është duke ndodhur ndonjë situatë me elemente të konfliktit të interesit, se ka ndodhur më parë. Në kuadër të burimeve duhet përmendur: mediat (e shkruara dhe elektronike), informatat e qytetarëve, regjistrat zyrtarë (dosjet e tenderëve) si dhe regjistrat private (kontratat për kryerjen e punëve).

Mirëpo, këto burime nuk kufizohet vetëm me kaq, AKK-ë ka grumbulluar të dhëna edhe nga burime të tjera, p.sh. nga formularët për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, plotësuar nga vet zyrtarët. Departamentit të Parandalimit, përkatësisht Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka zhvilluar bashkëpunim të ngushte kryesisht me Agjencinë Kosovar për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), Administratën Tatimore të Kosovës, Agjencinë për Regjistrim Civil, si dhe edhe me institucione të tjera.

Sanksionet e parapara sipas ligjeve ne fuqi : Deri në vitin 2013 konflikti i interesit në Kosovë ligjërisht ka qenë i sanksionuar si kundërvajtje, kurse me Kodin Penal nga ky vit është sanksionuar edhe si vepër penale. Konflikti i interesit në parim rregullohet me ligj të veçantë por dispozita që e rregullojnë këtë materie gjenden edhe në shumë ligje nga fusha të tjera.

Politika ndëshkimore sipas LPKI është paraparë vetëm në rastet kur konflikti i interesit përbën kundërvajtje. Rrjedhimisht, dënimet për kryerje të konfliktit të interesit kur ato nuk përbëjnë vepër penale por kundërvajtje ose lloj tjetër të shkeljes ligjore, janë prej 500 deri në 2.500 Euro si dhe Masa siguruese Ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3 muajve deri në 1 vjet.

Mos respektimi i rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit shkakton pasoja shumëdimensionale, si p.sh: Humbja e besimit të publikut në institucione; Cenimi i ushtrimit të funksionit publik në mënyrë të ligjshme dhe të ndershme; Përfitimi në mënyrë të kundërligjshme; Keqpërdorimi i detyrës zyrtare. Moszbatimi konsekuent i ligjit etj.

Në punën e saj 10 vjeçare në çështjen e Konfliktit të Interesit, AKK ka trajtuar një numër të madhe zyrtarësh duke përfshirë zv. Kryeministria, Ministra, Deputet, Kryetar Komunash, zyrtar nga niveli Qendror dhe Lokal, Zyrtar të Ndërmarrjeve Publike, Institucioneve të pavarura etj.

Nga kjo mund të themi se roli i AKK-se si Institucion i pavarur dhe kompetent në çështjen e Parandalimit të Konfliktit të Interesit ka rezultuar në masë të dukshme në përmirësimin e qeverisjes së mirë dhe transparente nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Tabela e mëposhtme tregon me saktësi numrin e rasteve të trajtuara për Konfliktin e Interesit nga AKK që nga viti 2007 – 2016.



## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Rastet e trajtuara për Konflikt të interesit, 2007 – 2016							
Vitet	Rastet e paraqitura	Rastet e shmangura nga K.I	Rastet pa konflikt Interesi	Opinione	Rastet e përcjella për hetim	Kërkesa për shkarkim/kundërvajtjeje	Këshillim
2007	15	15					
2008	45	26	19				
2009	47	15	27	5			
2010	65	49	16				
2011	54	30	13	7		4	
2012	131	98	25	4	2	2	
2013	238	181	27	20	9	1	
2014	264	138	34	46	3	7	
2015	306	160	39	49	3	4	
2016	81	84	16	22		8	
<b>Totali</b>	<b>1246</b>	<b>796</b>	<b>216</b>	<b>153</b>	<b>17</b>	<b>26</b>	<b>38</b>

## PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK

Me Ligjin Kundër Korrupsionit sfera e prokurimit publik ishte shumë pak e rregulluar dhe definuar/respektivisht kompetencat e AKK në këtë drejtim ishin shumë të limituara, prokurimi publik rregullohej shumë pak. Mirëpo përkundër kësaj AKK edhe pse në fillim të funksionalizimit, me kompetenca tejet të kufizuara dhe me një staf shumë të vogël ka arritur që të përcjell proceset e tenderimit në institucionet publike duke rekomanduar edhe anulimin e shumë proceseve tenderuese për shkak të gjetjeve të shkeljes së ligjit të prokurimit publik të cilat rezultojnë edhe me aspektin korruptues, duke u bazuar edhe në këtë sipas raportimit për vitin 2007 del se AKK ka rekomanduar që të anulohen tender me vlerë 7000,000.00 euro (7 milion euro).

Me miratimin e ligjit Nr. 02/L-133 për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Funksionin Publik, gjendja sa i përket parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik pothuajse nuk ndryshoi fare, E njëjta gjë vazhdoi edhe me nxjerrjen e Ligjit Nr. 03/L-155, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, gjendja sa i përket kompetencave në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik kishte serish ndryshime minimale. Përkundër kësaj AKK në bazë të kompetencave të cunguara ligjore vazhdoi që të parandalojë korrupsionin në këtë segment mjaft të ndjeshëm, i ndjeshëm për shkak se pothuajse gjysma e buxhetit të Kosovës shpenzohet përmes tenderëve/respektivisht proceseve të prokurimit publik, nga kjo del se këtu kemi të bëjmë me qindra miliona euro dhe se korrupsioni me i madh zhvillohet apo tentohet të zhvillohet në këtë segment. Progresi me i madh u arrit me ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili hyri në fuqi në vitin 2011, duke u bazuar edhe në këtë me vonë u krijua edhe një divizion i veçantë i cili merrej me monitorimin e proceseve tenderuese. Në bazë të kësaj u paraqiti nevoja edhe e rritjes së stafit dhe AKK filloi të rritej me staf, profesionalizmi u rrit dukshëm dhe serish në këtë kohë AKK, përmes punës së saj arriti që shumë procese tenderuese përmes opinionëve dhe rekomandimeve të saja të anulohet dhe në këtë aspekt edhe të shpëtojë buxhetin e Kosovës me miliona euro, nga proceset tenderuese të cilat në vetvete përmbajtshin elemente korruptuese.

Në bazë të këtij ligji Agjencia kishte të drejtë të merrte pjesë edhe në proceset vëzhguese të tenderëve, ku zyrtarët e këtij divizioni në bazë të gjeturave përgatiteshin edhe opinionet të cilat ju adresoheshin autoriteteve kontraktuese dhe në bazë të tyre edhe obligimet për anulimin e proceseve të cilat konstatoheshin se kishin shkelje të ligjeve në fuqi dhe përmbajtshin elemente korruptive.

Sot mund të themi lirisht se AKK përmes opinioneve të saja që i nxjerr sa i përket prokurimit publik drejtuar autoriteteve kontraktuese, dhe me anë të të cilave kërkon eliminimin e shkeljeve të LPP/respektivisht kërkon anulimin e tyre për shkak të dyshimeve dhe gjetjeve korruptuese, është një nder promotorët kryesor/respektivisht mekanizmat kryesor në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në proceset tenderuese në Kosovë, dhe në këtë mënyrë me opinionet e saj i kursen buxhetit të Kosovës me miliona euro si rezultat i korrupsionit që behet përmes prokurimit publik.

Tabela e mëposhtme tregon me saktësi rastet e trajtuara për parandalimin e shkeljeve ligjore për sa i përket procesit dhe procedurave të Tenderëve Publik gjatë viteve 2007 – 2016.

## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Parandalimi I Korrupsionit në prokurimin Publik 2007 – 2016					
Vitet	Rastet e paraqitura	Opinione	Vlera në Euro	Monitorim	Këshillim
2007					
2008	20	5	360,0000		
2009	5	1	1500,000	2	
2010	9	4	1758325,7	1	
2011	20	12	4935376,99	2	
2012	35	19	69353776,99	5	
2013	63	28	16575208,17	10	
2014	86	67	2868080,83	7	
2015	112	81	35277545	30	
2016	109	81	10918938,00	13	
<b>Totali</b>	<b>454</b>	<b>298</b>	<b>108,681,574,68</b>	<b>70</b>	<b>86</b>

## NGRITJA E KAPACITETEVE

Gjatë këtyre viteve AKK vazhdimisht është angazhuar që të ngrit kapacitetet e stafit të saj. Kjo për arsyen që të jetë në vazhdimësi në hap me trendët ndërkombëtare të metodave, taktikave dhe teknikave të hetimit dhe parandalimit të korrupsionit. Si rrjedhojë në tabelën në vijim mund të shihen trajnimet që stafi i AKK-së ka ndjekur nëpër vite. Nga totali i trajnimeve dhe pjesëmarrja e zyrtarëve në to del se mesatarisht të paktën një zyrtar ka marr pjesë në dy trajnime gjatë vitit. Për më shumë shih tabelën në vijim.

VITI	Nr. i TRAJNIMEVE	Nr. i ZYRTARVE
2007	47	66
2008	23	40
2009	29	41
2010	40	65
2011	24	38
2012	14	29
2013	19	63
2014	28	63
2015	20	79
2016	7	12
<b>TOTALI</b>	<b>251</b>	<b>496</b>

## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT



## BASHKËPUNIMI ME MEDIET

Duke pasur parasysh se shoqëria kosovare kishte nevojë për sensibilizim më të madh rreth korrupsionit, Agjencia gjatë këtyre viteve ka pasur fokus edhe bashkëpunimin e ngushtë me mediat, si mekanizëm i rëndësishëm i komunikimit me publikun. Mediat gjatë këtyre viteve kanë dhënë një kontribut të pa zëvendësuar në prezantimin e punës së AKK-së dhe të politikave të saj. Për të pasqyruar më saktë tabelat në vijim pasqyrojnë numrin e shkrimeve të mediave të shkruara që në një formë apo tjetrën kanë prezantuar punën e AKK-së, si dhe numrin e intervistave të drejtorit të AKK-së të dhëna në mediat vendore e ndërkombëtare.







## 10 VITE ME AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT

Numri i shkrimeve të mediave të shkruara për punën e Agjencisë sipas viteve	
Viti	Numri i shkrimeve
2016	42
2015	81
2014	179
2013	198
2012	132
2011	129
2010	115
2009	156
2008	140
2007	63
2006	49
<b>Totali</b>	<b>1284</b>

Numri i Intervistave të drejtorit të AKK-së në të gjitha mediat	
Viti	Numri i intervistave
2006	22
2007	52
2008	85
2009	93
2010	102
2011	105
2012	140
2013	140
2014	148
2015	108
2016	67
<b>Totali</b>	<b>1062</b>

Agjencia kundër korrupsionit i'u është mirënjohës të gjithë bashkëpunëtorëve dhe partnerëve vendor e ndërkombëtar të cilët kanë ndihmuar në ngritjen dhe zhvillimin e saj. Por në veçanti falenderonë UNDP-në zyra në Kosovë për ofrimin e ndihmës dhe kontributin e saj të pazavendësuar gjatë gjithë rrugëtimit tonë 10 vjeçar.

---



> LUFTIMI I  
KORRUPSIONIT

> PARANDALIMI I  
KORRUPSIONIT

> VETËDIJËSIMI KUNDËR  
KORRUPSIONIT

> DEKLARIMI I  
PASURISË

RAPORTI  
TANI

Pershkrimi

Shëno pershkrimin

E-mail

Shëno e-mail adresën

VAZHDO

Kërko: Shëno fjalë kyçe për kërkim të shpejtë



Shfrytëzo kërkimin e avansuar

KORRUPSIONI MBARON  
ME NDIHMEN TUAJ



0800 10800

thirrjet janë pa pagesë,  
konfidenciale dhe të  
besueshme

> LAJMET E FUNDIT



10 Dhjetor 2015

AKK i adreson opinion Komunes së  
Zvecanit



07 Dhjetor 2015  
AKK i adreson opinion Komunes së  
Prishtines



04 Dhjetor 2015  
AKK i adreson opinion Komunes së Gjilanit

> OPINIONET

> VENDIMET PËR KONFLIKT  
INTERESI

VEGËZA DIREKTE

- > Aktivitetet e prokurimit
- > Mundësi punësimi
- > Institucione dhe organizata  
vendore dhe ndërkombëtare

KONTAKTI

Agjencia Kundër Korrupsionit i  
mirëpret të gjitha kërkesat nga  
mediat të lidhura me mandatin e  
AKK-së.